

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Luxury Premium Finese” SHPK**

Sot me daten 13.01.2025, themeluesi:

Arben Meçaj i biri i Laver, i datelindjes 01.12.1961, lindur ne Fier dhe banues në Tirane, Shqipëri me adresë; Rruga Mustafa Matohiti, Njesia Bashkiake nr. 2, hyrja 1, apart 31, Tirane identifikuar me karte ID G11201017O, ne perputhje me Ligjin nr.9901, date 14.04.2008 i ndryshuar si edhe Ligjin nr.9723, date 3.5.2007, “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ka vendosur te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar “Luxury Premium Finese” Shpk.

Neni 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet “Luxury Premium Finese” Shpk.

Neni 2

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Hotel "Premium" Kryemedhenj, Golem, Kavaje. Shoqeria mund te hape filiale te tjera ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe ne te gjitha shtetet jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Te ushtroje aktivitetin ne fushen e hoteleri turizmit, bar restoran, floktore, komplekse e palestra sportive, fusha tenisi e minifutbolli, si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin ne fuqi. Eksport-Import dhe tregtim me shumice dhe pakice te te gjithe llojeve te materialeve e pajisjeve te ndertimit, te mallrave te ndryshme industriale e ushqimore, dhe mallra te te gjitha llojeve. Organizimi i udhetimeve turistike brenda dhe jashte vendit; Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi sherbimi e tregtimi, duke bashkepunuar me persona fizik e juridik vendas dhe te huaj. Pervec veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje cdo veprimtari qe do te konsiderohet nga Asambleja e Ortakeve si e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise dhe qe nuk vjen ne kundershtim me Ligjin Shqiptar.

Neni4

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise do jete 100.000 (Njeqindmije) Leke. Pjesmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e meposhtem qe nenkuptohet i perbere nga 1(nje)kuote me vlere te pergjithshme prej 100.000 leke. Kjo kuote i perket ortakut si me poshte:



1. Arben Meçaj zoterues i 1(nje) kuote me vlore te per gjithshme 100.000 leke me pjesmarrje 100% ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

Neni 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar.

Neni 6

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Administrator e shoqerise do te jete Zj.Mimoza Meçaj me karte ID Nr. G55331031H, e cila emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte rizgjedhje. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Administratori ka te gjithe kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve.

Neni 7

VENDIME TE ASAMBLESE SE PERGJITHESHME

Asamblea e per gjitheshme eshte organi me i larte vendimmarres.

Vendimet e asamblese se per gjitheshme merren bazuar ne per qindjen e kapitalit te zoteruar prej secilit ortak, konform pikes 1, neni 86 i ligjit 9901, dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

Te gjitha vendimet e marra nga Asamblea e Pergjithshme regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi do te shperndahet midis ortakeve respektivisht sipas kuotave te kapitalit themeltar te investuar te shprehura ne nenin 4 te ketij akti. Fitimi i destinuar per tu shperndare perbehet nga fitimi i vitit finanziar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven ligjore dhe te tjera



rezerva statutore, si dhe duke i shtuar apo zbritur respektivisht humbjet e mbartura nga vitet e meparshme.

Neni 9

LIKUIDIMI

Shoqeria eshte ne likuidim e siper qe ne momentin e prishjes se saj, operacion i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne legjislacionin tregtar shqiptar.

Neni 10

MOSMARREVESHJET


Mos marreveshjet zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, themeluesi do ti drejtohet Gjykates per zgjidhje.

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Luxury Premium FineSe” Shpk

Ortaku

Arben Meçaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Arben Meçaj".